



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS LIPJAN

Numri i lëndës: 2024:071994

Datë: 13.06.2024

Numri i dokumentit: 05816599

P.nr.93/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË LIPJAN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni penal, në përbërje prej gjyqtarit të vetëm gjykues Avdirrahman Gashi, me bashkëpunëtoreshen profesionale Gentiana Dakaj, në çështjen penale ndaj të pandehures A. R. nga L., e të cilën e akuzon PTH në Prishtinë, me aktakuzën saj PP.II.nr.179/24F të dt.29.02.2024, për shkak të veprës penale Dhuna në familje nga neni 248 par.1 të KPRK-së, në shqyrtimin gjyqësor, jopublik, të mbajtur me datën 03.06.2024, në prani të prokurorit të shtetit Paulin Pashku, të pandehures, dhe të të dëmtuarës Sh. R. nga fsh R., ndërsa me dt.05.06.2024 mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

Kundër të akuzuares:

A. R., e lindur me, në L., me vendbanim në rrugën "Sh. F." objekti banesor "...", në L., e bija e R. dhe e emës M. e vajzërisë L., me gjendje të mesme ekonomike, amvise, shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës, më parë e padënuar, mbrohet në liri.

Ë S H T Ë F A J T O R E

S E P S E

Me datë 10.02.2024, rreth orës 20:00 në rrugën "Sh. F.", në L., konkretisht në banesën e tyre me qera, për shkak të mosmarrëveshjeve të vazhdueshme me të dëmtuarën- vjehrrën e saj Sh. R., e njëjta ka ushtruar dhunë psikike në vazhdimësi ndaj të dëmtuarës, me qëllim të cenimit të dinjitetit të saj, ashtu që në ditën kritike, kur e dëmtuara është pastruar, e ka lënë tepihun e banjës, në pllaka të lagura, kjo nuk i ka pëlqye të pandehurës, dhe menjëherë ka filluar të fjaloset me të dëmtuarën duke i bërtitur, "Pse e ke lënë tepihun në pllaka të lagta", më pas e ka kap për dorë dhe i ka thënë "Largohu nga banesa", e ka marrë rrobat e të dëmtuarës, ka dashur ti largojë nga banesa, por ka ndërhyrë djali i të dëmtuarës dhe nuk e ka lejuar, po ashtu e pandehura e ka shqetësuar me fjalët "Ti ski rresë me mu, dil prej shpisë, banesa është e jemja, çka po rrin me neve, shko nshpi tanen në R.", si pasojë e këtyre veprimeve të dëmtuarës ia ka shkaktuar ndjenjën e frikës, ankthit dhe të pasigurisë për jetë,-

-me këtë ka kryer veprën penale Dhuna në familje nga neni 248 par.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të dispozitave të lartëcekura si dhe dispozitave të neneve 1, 2, 4, 6, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 42, 69 dhe neni 248 par.1 të KPRK-së, si dhe nenit 364 të KPPK-së, të akuzuares i shqipton:

DËNIM ME BURGIM DHE ME GJOBË

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 muajve, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotëfuqishmërisë së aktgjykimit dhe

Dënim me gjobë në shumë prej 300-€ i cili dënim do të ekzekutohet pas plotëfuqishmërisë së aktgjykimit. Në rast se dënimi nuk realizohet as me detyrim, gjykata dënimin me gjobë do ta zëvendësojë me dënim me burgim, konfrom nenit 43 par.3 të KPRK-së, ashtu që për çdo ditë të kaluar në burg, të llogaritet shuma prej 20-€.

E dëmtuara: Sh. R. nag fsh. R., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

DETYROHET e akuzuara që në emër të shpenzimeve të procedurës penale kësaj gjykate t'ia paguajnë paushallit gjyqësor shumë prej 50-€, si dhe shumë nga 20-€, në Fondin e Kompensimit të Viktimave, të gjitha këto në afat prej 15 dite pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë, me aktakuzën e saj PP.II.nr.179/24F të dt.29.02.2024 e ka akuzuar te akuzuarën A. R. nga L., për shkak të veprës penale Dhuna në familje nga neni 248 par.1 të KPRK-së.

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare ka deklaruar se pas përfundimit të procedurës së provave në këtë shqyrtim gjyqësor është vërtetuar dispozitivi i kësaj aktakuze dhe gjendja faktike e përshkruar si në aktakuzë e që do të thot se e pandehura A. R. ka kryer veprën penale Dhuna në familje nga neni 248 par.1 të KPRK-së. Këtë gjendje faktike është vërtetuar nëpërmjet dëshmisë së dëshmitarës – të dëmtuarës Sh. R. e cila në mënyrë identike sikurse në deklaratën e dhënë në polici edhe në seancën e sotme gjyqësore ka përshkruar faktet vendimtare të cilat e përbëjnë veprën penale dhuna në familje duke cekur se mosmarveshja me të pandehurën ditën kritike ka ndodhur për shkak se e dëmtuara e cila është moshës së vjetër shtyer e ka lënë tepihun e banjos në pllaka të lagura e kjo nuk i ka pëlqyer të pandehurës e cila ka filluar të fjaloset me të dëmtuarën, e më pas i ka marur edhe rrobat e të dëmtuarës që ti largoj nga banesa por ka ndërhyr dëshmitari K. R.. Ky version i palës së dëmtuar dëshmitarës Sh. R. përputhet në tërësi edhe me deklarinimin e dëshmitarit K. R. i cili gjithashtu e ka përshkruar motivin e kryerjes së veprës penale po ashtu duke cekur se mosmarveshja kishte filluar për shkak të tepihut që e dëmtuara e kishte vendosur në pllaka të lagura, i njëjti dëshmitar gjithashtu e ka vërtetuar verzionin e palës së dëmtuar Sh. R. se e dëmtuara i kishte marur rrobat e të dëmtuarës që ti largoj dhe i ka thënë lëshoj ato tesha qka je tu ba dhe përfundimisht këtë gjendje faktike e pranon edhe vet e pandehura e cila e pranon se ka pasur fjalosje mes saj dhe të dëmtuarës Sh. R. por jo dhunë fizike, fakt të cilën e cek e dëmtuara Sh. R. dhe mbi të gjitha këto prova vërtetohet se ditën kritike ka ndodhur dhuna psikologjike ndaj të dëmtuarës si element përbërë i veprës penale dhuna në familje dhe ka kërkuar që e akuzuara të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

E dëmtuara në fjalën përfundimtare ka deklaruar se nuk dëshiron që e akuzuara të dënohet, por ka kërkuar që të njëjtës ti bëhet me dije se është sjellur keq me mua edhe më parë por ditën kritike nuk kam pasur qare pa e lajmëruar.

E akuzuara në fjalën përfundimtare ka deklaruar se nuk ka bërë asgjë dhe kërkoj që të lirohet nga akuza.

Për vërtetimin e gjendjes faktike dhe gjykuar drejtë në këtë çështje juridiko-penale gjykata në procedurën e provave me propozimin e palëve ka bërë adiministrimin e provave dhe atë me dëgjimin e të dëmtuarës në cilësinë e dëshmitares Sh. R. nga fsh. R., me dëgjimin e dëshmitarit K. R. nga fsh. R. me vendqendrim në L., me dëgjimin e dëshmitarit A. M. nga P., me shiqmin dhe leximin e Raportit mjekësor te lëshuar nga QKMF Lipjan dt.10.02.2024, dhe pas marrjes se dekalrtës se të akuzares A. R., e të cilat prova gjykata e të cilat prova gjykata i administroi dhe i vlerësoi në pajtim me nenin 7 dhe lidhur me nenin 360 të KPPK-së, ashtu që gjykata me ndërjegjëje i vlerësoj çdo provë veç e veç dhe të gjitha bashkarisht e të cilave

gjykata ua fali besimin, ku u vërtetua e akuzuara A. R., ka kryer veprimet penale Dhuna në familje nga neni 248 par.1 të KPRK-së, respektivisht në mënyrë bindëse u vërtetua gjendja faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga dëgjimi i të dëmtuarës-dëshmitares, Sh. R. vëretohet se e njëjta edhe më parë dhe që 15 vite që është martuar me djalinë saj me të akuzuaren kanë pasur mosmarveshje dhe për këto raste nuk ka i paraqitur në polici. Ditën kritike e ka bërë lajmërimin në polici sepse nuk ka pasur qare dhe këtë ditë ja ka marrë paraprakisht djalinë të vëllaut tim A. M. shumën prej 150 euro dhe i ka thënë me këtë datë se pse spo ja kthen parat djalinë, e njëjta më ka kthyer përgjigje se do t'ia jap nga se edhe më parë është mësuar prej ti me marrë para. Ditën kritike pas këtyre fjalëve ka desht me hy në banjo me u pastruar dhe e ka pa tepihin e banjos të lagur dhe pasi ka dalë prej banjos thash ta marr tepihin dhe e ka qitur me terë, e akuzuara kur e ka pa pak të lagur, e ka kthyer me fjalë të ndryshme ti je "e pislafit" dhe fjalë të tjera fyese dhe ka dasht me ja qitë teshat jashtë dhe me ka thënë se banesën e ka marrë për burin e saj dhe fëmijët dhe ti e ka shtëpinë në katund dhe shko atje ku këtë qira të banesës e paguan djali i saj K.. Ku ndër të tjerat ka theksuar se se Korabi është i birësuar dhe i njëjti e ka shitur një hektar e 40 ari tokë dhe i ka shpenzuar me gruan, qka ka dasht, po ashtu edhe me gruan i ka shpenzuar, ku pas atij momenti e dëmtuara ditën kritike ka dalë prej banesës dhe është strehuar në shtëpinë e vëllaut të saj B. M..

Nga dëgjimi i dëshmitarit K. R., vëretohet se qëndron në tërësi pranë deklaratës që e ka dhënë në polici. Ka shtuar se ditën kritike ka qenë në punë dhe në mbramje ka ardhur prej punës rrethë orës 08,00 minuta, banesa kishte qenë e hapur, familja normal, dhe që të dyja kanë qenë në sallon bashkë, ma kanë bërë bukën gati, qajin dhe kur ka ardhur nëna ka qenë e pastruar, e veshur normal dhe nuk ka pa asnjë mosmarveshje në mes tyre. Poashtu ka deklaruar se kanë pasur mosmarveshje mes tyre rrethë një tepih të vendosur në banjo nga nëna ku paraprakisht i ka thënë se mos e qitë tepihin e tert në banjo të lagët kjo ja ka kthyer me disa fjalë se mos mu përzi, e di qka baj unë dhe disa fjalë i ka thënë, me kanë e mira nuk e kishte lajmëru burin tënd në polici për dhunë në familje që ka ndodhur para 4 viteve dhe në ato momente është nxehur situata dhe gruaja ime është nervozuar dhe në ato momente e akuzuara i ka marrë teshat e nënës për ti gjuajtur dhe në ato momente i kam thënë leje qka je tu ba, në ato momente gruaja ime është ndalë dhe pas 10 minutave janë qetësuar dhe gruaja ime na ka qitë kafe që të tret bashkë dhe në ato momente nëna e ka veshur një trenerk pasi ka pi kafe dhe ka dalur jashtë nuk është kthyer më atë natë. Unë kam marrë veturën pas 5 minutave dhe kam dalur me veturë për ta kërkuar që të kthehet në banesë dhe më se kam parë dhe pastaj më ka thirrur policia në telefon dhe kam kuptuar që nëna ka shkuar në polici pas deklaratës së policisë nëna që ka thënë dhe mu më kanë dërguar në dhomë me nënën dhe i ka thënë se nanë qka bëne dhe ajo më tha qysh ta ka bërë gruaja ty dhe unë ja kam bërë asaj. Kurrë nuk kam pasur probleme me nënën por me familjen tjetër sepse unë jam i adaptuar i saj dhe me migjallar probleme me pronë kemi pasur sepse unë kam qenë i adaptuar sepse mu skan dasht me ma lan pronën, pronën e shitur më parë e kemi shpenzuar bashkarisht me familje dhe nëna është duke nderitur tash në fsh. R., i kam thënë hajde në banesë por nuk po vjen dhe nga Shtatori 2023 jetoj në banesë në L. me qira ndërsa nëna nga data që ka ndodhur kjo mosmarveshje ka shkuar në R..

Nga dëgjimi i dëshmitarit A. M., vëretohet se qëndron në tërësi pranë deklaratës së dhënë në polici, Sh. ka ardhur me dt.10.02.2024 në orët e vona pasi paraprakisht më ka thirrur në telefon paraprakisht K. duke më thënë paraprakisht hajde mere hallën nja 3-4 dite dhe pasi jam përgaditur jam nisur për Lipjan dhe pastaj e kam thirrur në telefon duke e vet për qka e kam vet dhe më ka thënë se në Stacionin Policor në Lipjan është. Poashtu kur kam ardhur në SP në Lipjan i kam thënë qka është puna me hallën K. ma kthej përgjigjjen se gruaja nuk pe don. Policia edhe këta kanë dasht me dërgu në strehimore sepse policia më kanë thënë se këta nuk po e dojnë në shtëpi por i kam thënë unë se ka vend tek ne dhe ne e mbajmë dhe nuk e lëjmë në strehimore, që 15 vite prej kur është martuar K. kanë pasur probleme dhe unë ja kam thirrur babën A. për tu marrë vesh sepse unë kam qenë mësuar kur është martuar me K. dhe baba i saj nërsy i thojke se ta gjej tjetrin ma të mirë në Gj. dhe gjithqka qka them është e vërtetë. Po ashtu ka shtuar se çdo herë kanë pasur mosmarveshje por gjithmonë jemi mundu me qetësu gjendjen. Gjithashtu ka deklaruar se

çdo herë jemi kujdesur për të sepse nuk ka pasur fëmijë, mirëpo me të martuar K. kanë filluar problemet edhe pronësore sepse do tokë dhe gjë sende gjitha ja kanë shitur, ju kam ndihmuar financiarisht sepse ne jemi në gjendje të mirë ekonomike dhe hatri i hallës unë personalisht i kam ndihmuar personalisht me thëngjill, tona sendet dhe jam kujdesur për ta dhe ja kam dhënë 150 euro K. dhe asnjëherë nuk mi ka kthyer dhe jo që ja kam lyp por ne jemi të interesuar që këta të kalojnë mirë mes veti burrë e grua dhe të kan respekt për hallën tonë sepse kjo e ngrata pa fëmijë e ka adaptuar K. dhe është kujdesur për to.

Nga Raporti mjekësorë i lëshuar nga QKMF- Lipjan i dt.10.02.2024 vërtetohet se me këtë datë në orën 21:45 min ka kërkuar tretman mjekësor e dëmtuara Sh. R. nga L., e cila është ankuar me hiper tension dhe i është rekomanduar terapia adekuate.

E akuzuara në shqyrtimin gjyqësorë ka deklaruar se me dt.10.02.2024 nuk ka ndodhur asgjë përveq që një tepi të banjos e ka vendosur e dëmtuara dhe i ka thënë hiqe dhe në këto momente i kemi pasur disa fjal sepse qeshmja po rrjedh dhe njëherë më është rrëzuar qika në banjo dhe me ra diqka nuk kemi pasur në mes veti asgjë. Ditën kritike i kam kapur rrobat më i gju por nuk i kam gjuajtur nga se në ato momente ka ndërhyrë K. se qka po bënë dhe ne edhe më herët kemi pasur probleme, dhe se e dëmtuara është larguar nga shtëpia, dhe se nga ajo datë kur është dalur nga banesa ma nuk është ardhur Sh. për të jetuar me neve. Mirëpo herë pas here vjen me nejt me i pa fëmijët. Prej ati momenti që është lajmëru rasti në polici ma unë nuk kam folur me to.

Pra, nga provat e administruara e të cilave gjykata iu fali besimin në mënyre të plotë dhe të bindshme, përtej çdo dyshimi të bazuar, është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të aktakuzës dhe se me veprimet e të akuzuares, përtej çdo dyshimi vërtetohet se manifestohen elementet e vepres penale Dhuna në Familje nga neni 248 par. 1 të KPRK-së dhe se në rastin konkret gjykata nuk gjeti asnjë rrethanë që e përjashton ndjekjen penale ose përgjegjësinë penale, andaj të akuzuaren gjykata e shpalli fajtores dhe i shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Matja dhe caktimi i dënimit

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuaren, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese konform nenit 69 të KPRK-së, ashtu që prej rrethanave lehtësuese gjykata vlerësoi rrethanat para kryerjes se veprës penale, pra faktin se e njëjta për herë të parë ka rënd ndesh me ligjin, rrethanat personale dhe familjare pra, faktin se e njëjta është nënë e katër fëmijëve të vegjël dhe e re që lenë për të kuptuar se në të ardhmen mund të bëhet anëtare e dobishme e shoqërisë, ndërsa si rrethana rënduese gjykata vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale për të akuzuaren pra, faktin se në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë e aftë për t'i kuptuar sjelljet dhe veprimet e veta inkriminuese dhe duke marr për bazë shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale (pra faktin se e akuzuara është në dijeni se burri i saj është i adaptuari i të dëmtuarës e cila e ka rritur nga vogëlja, burri i të akuzuarës e ka trashëguar pasurinë e burrit të të dëmtuarës vetëm që të ketë në pleqëri një kujdesje më të mirë nga ana e të adaptuarit dhe sjellja e tillë tepër e vrazhdët dhe në shqyrtimin gjyqësor, ku qëllimi i saj shifet se është më tepër për ta larguar nga shtëpia dhe për të jetuar e vetme me burrin e saj tregon se sjellja e saj respektivisht dhuna psikike ndaj të dëmtuarës paraqet një shkallë të lartë të rrezikshmërisë së lartë shoqërore) andaj të njëjtes gjykata i shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke qenë e bindur se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit konform nenit 38 të KPRK-së, e cila dispozitë ka për qëllim që të parandaloj kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e saj, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Me rastin e vendosjes gjykata vlerësoi mbrojtjen e të akuzuarës mirëpo të njëjtën mbrojtje e refuzoi si të pabazuar nga se nga provat e administruara u vërtetua gjendja faktike se e akuzuara ditën kritike ka ushtruar dhunë psikike ndaj të dëmtuarës duke i bërtitur pse i ke lenë tepihun në pllaka të lagura, ku edhe në një moment e ka kapur për dore duke i thënë largohu nga banesa

dhe ia ka marrur rrobat ku ka dashur ta largoj nga banesa me ç'rast ka ndërhyer djali i të dëmtuarës dhe nuk e ka lejuar dhe fjalë të tjera fyse si ski rrenës me neve, dil prej banese etj., fjalë pra sjellje të tillë që ka pasur edhe më parë mirëpo e dëmtuara duke u munduar ta ruaj gjendjen në familje nuk e ka lajmëruar rastin në polici, ndërsa në ditën kritike për shkak të kësaj sjellje tepër të rëndë ofenduse është detyruar që të largohet dhe ta lajmroj rastin në polici dhe këtë sjellje të të akuzuarës paraqesin dhunë psikologjike ndaj të dëmtuarës të cilat kanë për qëllim cenimin e dinjitetit të saj e cila është në mardhënie familjare me të akuzuarën, veprime këto të cilat gjykata i konsideroi tepër të rënda për shkak të gjendjes statusore në familje e të cilën e dëmtuara e ka adoptuar dhe e ka rritur që nga femëria me qëllim dhe ka obligim ligjor iadoptuari që të kujdeset për prindin adoptues në pleqëri, e për më tepër kur të gjithë pasurin e burrit i cili ka ndërruar jetë ia ka lënë djalit të të adoptuarit, mirëpo e akuzuara me qëllim që të jetoj vetëm me burrin e saj e duke ditur që ky i fundit ka qenë i adoptuari i të dëmtuarës në vend që të ketë përkujdesje më të madhe ajo është sjellur vazhdimisht në mënyrë të vrazhdët ku e ka cenuar dinjitetin e saj në familje me shprehje të ndryshme që e kanë rënduar në mënyrë psikologjike gjendjen emocionale të të dëmtuarës. Pra, gjendja faktike është vërtetuar nga provat si dëshmia e të dëmtuarës, dëshmia e dëshmitarit A. M. dhe pjesërisht edhe nga dëshmia e dëshmitarit K. R. dhe deklarata e të akuzuarës të cilët e kanë pranuar se ditën kritike ka pasur mosmarrëveshje ndërmjet të akuzuarës dhe të dëmtuarës por pjesërisht duke u munduar ta paraqesin një gjendje tjetër me qëllim të shmangjes së përgjegjësisë penale për të akuzuare.

Vendimi për shpenzimet e procedurës

Vendimi për shpenzimet e procedurës u bazua në nenin 449 dhe 450 të KPPK-së, ku shuma prej 20-€ në emër të paushallit gjyqësor u caktua në bazë të ndërlëshmerisë së rastit, ndërsa shuma prej 20-€ për Kompenzimin e Viktimave të Krimit u bazua në nenin 36 të Ligjit për Kompenzimin e Viktimave të Krimit.

Kërkesa pasurore-juridike

Vendimi për kërkesën pasurore-juridike u bazua në nenin 462 të KPPK-së, dhe në këtë rast pala e dëmtuar u udhëzua që kërkesën pasurore-juridike ta realizojnë në procedurë të rregullt gjyqësore ngase gjykata në mungesë të provave materiale nuk ka mundur të vendos për kërkesën pasurore-juridike.

Nga arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË LIPJAN
P.nr.93/24 dt.05.06.2024

GJYQTARI
Avdirrahman Gashi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 30 dite nga dita e dorëzimit të të njëjtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2024:071994
Datë: 13.06.2024
Numri i dokumentit: 05816599